REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. i faq / Broj stranica / Nr. pages 03
Nr. Prot. / Br.Prot. / Prot No. 06-2571/19
Data / Datum / Date 22-10-2019
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të Nenit 11 (paragrafi 1.1), Nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), Nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit si dhe Nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 16.10.2019, mori:

V E N D I M

I. ***Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02-1023/19, për zyrtarin e lartë z. Blerand Stavileci, Shef i Stafit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur situatën e konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, duke dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues - Kryetar i Klubit të Basketbollit Prishtina .***

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me numër protokolli AKK–03-02-1023/19, është hapur me dyshimin e konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Blerand Stavileci, Shef i Stafit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës. Agjencia Kundër Korrupsionit, rastin e ka trajtuar konform procedurave për shqyrtimin dhe trajtimin e situatave të konfliktit të interesit të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas verifikimit të informacionit dhe të dhënave tjera si dhe pas kërkesës qe e ka drejtuar në Agjencinë kundër Korrupsionit vet zyrtari i lartë për të marr një mendim lidhur me funksionet e tij, është konstatuar se zyrtari i lartë z. Blerand Stavileci, si Shef i Stafit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në të njëjtën kohë është duke ushtruar funksion drejtues: Kryetar i Klubit të Basketbollit Prishtina.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik. Bazuar në Nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës jo qeveritare. Prandaj, në kuptim të kësaj, Agjencia Kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar shqyrtimi i gjendjes së Konfliktit të Interesit.

Pas kësaj shkrese, z. Blerand Stavileci, Shef i Stafit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës ka ardhur në zyrat e Agjencisë Kundër Korrupsionit për tu njoftuar me faktet lidhur me inicimin e rastit për situatë të konfliktit të Interesit në ushtrim të funksionit publik. Gjatë takimit me zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zyrtarit të lartë z. Stavileci, i janë prezantuar faktet dhe i janë ofruar sqarime lidhur me rastin e iniciuar.

Zyrtari i lartë, z. Stavileci, ka deklaruar se nuk ka pasur njohuri rreth ndryshimeve që ka sjell Ligji i ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konkretisht sa i përket kufizimit që rrjedh për funksionin drejtues në organizatat jo Qeveritare, në ketë rast si Kryetar i Klubit Sportiv të Basketbollit Prishtina, mirëpo përkundër kësaj i njëjti ka deklaruar se do të veproj sipas obligimeve ligjore.

Pas këtij takimi, zyrtari i lartë z. Blerand Stavileci, nëpërmes shkresës zyrtare na ka njoftuar se pas kërkesës nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe me qëllim të evitimit të çfarëdo situate të konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, ka ofruar dorëheqjen me shkrim si Kryetar i Klubit të Basketbollit Prishtina. Nga data e ofrimit të dorëheqjes 24.06.2019 z. Stavileci nuk ushtron më funksionin e Kryetarit të Klubit të Basketbollit Z-Mobile Prishtina.

Me këtë rast, Agjencia Kundër Korrupsionit konstaton se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Blerand Stavileci, Shef i Stafit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dhe Anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, dorëheqjes nga funksioni si Kryetar i Klubit të Basketbollit Prishtina, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik nga zyrtari i lartë. Sa i përket pretendimeve tjera të paraqitura lidhur me këtë zyrtar, Agjencia Kundër Korrupsionit ka vlerësuar se si të tilla nuk janë të mjaftueshme për të konstatuar konfliktin e interesit apo kufizime tjera, konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të Nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit